

VENDIM
Nr.796, datë 7.11.2007

PËR MIRATIMIN E KONTRATAVE, ME NDARJE PRODHIMI, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË SHQIPËRI, NË TOKË, NË BLOQET A-B DHE D-E, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, E PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN) DHE DWM PETROLEUM AG

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratave, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në blloqet A-B ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe DWM Petroleum AG, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e kontratave, me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në blloqet D-E, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe DWM Petroleum AG, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha